



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201701064/12

Tiranë ___/___/2017

Lënda : *Rekomandim për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr.560 datë 13.09.2017, të Drejtorit të Përgjithshëm të QSU "Nënë Tereza", Tiranë.*

Drejtuar : **Drejtorit të Përgjithshëm**
QSUT "Nënë Tereza"
Z. Enkelejdi Joti

TIRANË

I nderuar z. Drejtor i Përgjithshëm,

Sikurse jeni në dijeni, pranë Institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur një ankesë z. P.V, mjek pranë Urgjencës të Sëmundjeve të Brendshme, QSU "Nënë Tereza", Tiranë, në të cilën ngrihet shqetësimi ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të këtij institucioni, në lidhje me shkejen e të drejtës tij të ligjshme, për mbrojtjen shoqërore të punës dhe për shkelje të personalitetit dhe integritetit si mjek.

Në ankesën e tij, shtetasi P.V i referohet rastit të një pacienti me agjitim psikomotor për determinim, të paraqitur në Urgjencën e Sëmundjeve të Brendshme të QSU "Nënë Tereza" më datë 17.08.2017. Ai sqaron veprimet e kryera nga ana e tij si mjek, nga momenti i paraqitjes të pacientit në ambientet e kësaj Urgjence dhe më tej, trajtimin e të sëmurit, duke respektuar protokollin e miratuar nga Ministria e Shëndetësisë, për rastin e pacientëve që paraqesin probleme me këtë diagnozë.

Drejtori i Përgjithshëm i QSUT "Nënë Tereza", duke marrë shkas nga kjo ngjarje, me shkresë Nr.prot. 3467, datë 19.08.2017 drejtuar z.P.V, ka njoftuar për zhvillimin e një takimi në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore më datë 06.09.2017, ora 11.00, për të diskutuar mbi situatën e ndodhur në Urgjencën e Sëmundjeve të Brendshme më datë 17.08.2017. Ky takim për arsye të brendshme të institucionit u shty dhe u zhvillua në datë 07.09.2017, ora 11.00.

Z.P.V sapo është vënë në dijeni të njoftimit për takimin, është drejtuar me ankesë disa titullarëve të Institucioneve të larta shtetërore, midis tyre dhe Avokatit të Popullit, ku thekson se, procedura administrative për dhënien e masës disiplinore filluar nga organi

juaj është selektive, diskriminuese dhe ka për qëllim dëmtimin e personalitetit dhe integritetit tij si mjek. Ndërkohë, siç shprehet ankuesi, situata e ndodhur më datë 17.08.2017 në Urgjencën e Sëmundjeve të Brendshme të QSU “Nënë Tereza”, është një situatë normale pune dhe trajtimi saj si një rast specifik, nuk përbën shkak ligjor për fillimin e kësaj procedure administrative.

Mbi këtë bazë dhe duke e cilësuar njoftimin tuaj për zhvillimin e takimit me shkresën Nr.prot. 3467, datë 19.08.2017, si jo të drejtë dhe të pabazuar në ligj, nga ana e ankuesit kërkohet ndërhyrja dhe ndërmjetësimi i Avokatit të Popullit, për pranimin e kërkesës në lidhje me shkejen e të drejtës tij të ligjshme, për mbrojtjen shoqërore të punës dhe për shkelje të personalitetit dhe integritetit si mjek, si dhe për trajtimin dhe zgjidhjen e këtij shqetësimi sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Institucioni i Avokatit të Popullit, për nevoja të shqyrtimit të kësaj ankese, kërkoi shpjegime me shkresë Nr.K3/P10-2 prot., datë 05.09.2017, pranë jush. Përgjigja juaj referuar shkresës nr.K3/P10-4 prot., datë 14.09.2017 sqaronte trajtimin që do t’i bëhej në vazhdim kësaj çështjeje, dhe bazës ligjore mbi të cilën mbështetet njoftimi dhe njëkohësisht fillimi i procedurës administrative për dhënien e masës disiplinore Dr.P.V. Në rast vendimmarrjeje mbi këtë rast, ne kërkua gjithashtu dërgimin e një kopjeje të vendimit përkatës të marrë nga organi që ju përfaqësoni dhe të proces-verbalit, të mbajtur në mbledhjen e njoftuar dhe zhvilluar në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të institucionit tuaj.

Nisur nga kërkesa e ankuesit dhe afati i përcaktuar në njoftimin tuaj për zhvillimin e takimit më datë 06.09.2017 në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, dy ekspertë të institucionit tonë, janë paraqitur pranë zyrave të Institucionit tuaj më datë 07.09.2017 dhe kanë marrë takim me Ju. Në këtë takim, pasi është bërë prezent qëllimi i kërkesës tonë, ju deleguat për kompetencë vazhdimin e takimit me Zv/Drejtoreshën e Përgjithshme, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit për shqyrtimin e kërkesave, ankesave dhe të propozimit organit përkatës, për dhënien e masave disiplinore të punonjësve të këtij Institucioni.

Nga ana e saj, Zv/Drejtoresha e Përgjithshme e QSU “Nënë Tereza”, Tiranë pasi ka dhënë shpjegimet në lidhje me rastin dhe mënyrën e trajtimit që është bërë kërkesës të titullarit të institucionit në mbledhjen e zhvilluar më datë 07.09.2017, na informoi se në takim, përveç trajtimit të problematikës të ngritur nga personat që kanë qënë prezent në ambientet e Urgjencës në momentin e paraqitjes të pacientit, ka marrë pjesë dhe janë dëgjuar edhe pretendimet e mjekut P.V. Nga ana jonë, kemi kërkuar që në përfundim të vlerësimit dhe konkluzioneve për ngjarjen, të nxjerra nga proces verbali i mbajtur për këtë qëllim, të dërgonin pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, brënda afatit 5 ditor informacionin dhe dokumentacionin bashkëngjitur.

Ju në përgjigje të kërkesës tonë, me shkresë Nr.3467/13 prot. datë 12.09.2017, na informoni se, më datë 17.08.2017 është protokolluar shkresa me Nr.3450 prot., referuar ankesës të një grupi punonjësish të Policisë të Shtetit, në të cilën përshkruhet situata e ndodhur në ambientet e Urgjencës të Sëmundjeve të Brendshme, e cila sapo është vënë në dijeni të rastit në bashkëpunim me policinë private që ka në ruajtje QSUT “Nënë Tereza”,

kanë bërë të mundur neutralizimin e një personi agresiv të paraqitur pranë kësaj Urgjence. Ndërkohë, sipas këtij informacioni, një nga mjekët e këtij shërbimi z.P.V, në detyrën e mjekut të Triazhit, nuk ndërmorri asnjë masë për dhënien e ndihmës shëndetësore, por vetëm pasi vuri re prezencën e titullarit të Institucionit në ambientet e Urgjencës, ka reaguar duke kryer injektimin e Diazepamit dhe ka njoftuar ambulancën për dërgimin e pacientit të sëmurë në Shërbimin e Psikiatrisë, për verifikimi të mëtejshëm të gjëndjes së tij mendore.

Gjithashtu, në këtë informacion, theksohet se: *“Mbi rrethanat e ngjarjes, e referimin e bërë nga Policia e Shtetit, për kompetencë e vendimarrje.....i jemi adresuar Urdhërit të Mjekëve të Shqipërisë, i cili në përgjigjen e tij Nr.103/1 prot., datë 08.09.2017....ndër të tjera informon se ka filluar praktikën e shqyrtimit të ankesës...”*. Në përfundim të kësaj përgjigje thuhet se: *“...Në takimin e caktuar më datë 07.09.2017 është mbajtur proces verbali përkatës, i cili është ende në proces vlerësimi”*.

Por, pamvarësisht përgjigjes të lartpërmendur dhe ende pa përfunduar shqyrtimi i kësaj çështje nga Urdhëri i Mjekëve të Shqipërisë, ankuesi është njohur me Vendim Nr.560 datë 13.09.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm të QSUT “Nënë Tereza”, për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës dhe ndërprerjen e marrëdhënieve financiare më datë 29 Dhjetor 2017. Kopje e këtij Vendimi është vënë në dispozicion të Institucionit të Avokatit të Popullit nga ana e anuesit P.V, menjëherë.

Ndodhur në këto kushte, Institucioni i Avokatit të Popullit i është drejtuar Presidentit të Urdhërit të Mjekëve të Shqipërisë me shkresë Nr.K3/P10-9 prot. datë 19.09.2017, me kërkesën që pasi të përfundonin shqyrtimin e praktikës lidhur me gjykimin disiplinor profesional të rasti Dr.P.V, adresuar nga Drejtoria e Përgjithshme e QSUT “Nënë Tereza”, të na dërgonin një kopje të vendimit të këtij organi. Institucioni ynë tashmë ishte i përfshirë në procedurën e shqyrtimit të çështjes dhe ka detyrimin ligjor që të njihet me të gjitha informacionet, aktet dhe dokumentet që kanë të bëjnë me procedurat e shqyrtimit të saj nga organet shtetërore.

Urdhëri i Mjekëve të Shqipërisë me shkresë Nr.108/1 prot. datë 11.10.2017 informon institucionin tonë se, në zbatim të Rregullores së Gjyimit Disiplinor Profesional, Këshilli Kombëtarë i Urdhërit të Mjekëve të Shqipërisë i ka kaluar për kompetencë këtë ankesë, Këshillit Rajonal të Urdhërit të Mjekut Tiranë dhe sapo të merret një Vendim në lidhje me këtë rast do të na dërgohet një kopje e këtij vendimi.

Shtetasi P.V si palë e interesuar në këtë proces, pasi ka marrë pjesë dhe është dëgjuar në mbledhjen e Komisionit Disiplinor Profesional të Këshillit Rajonal të Urdhërit të Mjekut të Shqipërisë, zhvilluar në datë 09.10.2017, për shqyrtimin e kërkesës të paraqitur nga QSU “Nënë Tereza” kundrejt tij, sapo është vënë në dijeni të Vendimit Nr.9, datë 09.10.2017 të këtij organi, kopjen e tij e ka vënë menjëherë në dispozicion të Institucionit tonë.

I nderuar z. Drejtor i Përgjithshëm,

Nga gjithë informacioni që na është dërguar për këtë çështje evidentojmë se, pamvarësisht Vendimit Nr.560, datë 13.09.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm të QSUT “Nënë Tereza”, “Për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës” të z.P.V, çështja e ligjshmërisë në zbatim të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore lidhur me rastin e lartpërmendur, është gjykuar nga Komisioni Disiplinor Profesional i Këshillit Rajonal të Urdhërit të Mjekut të Shqipërisë. Referuar **Vendimit Nr.9, datë 09.10.2017** të këtij organi, Komisioni pasi ka vlerësuar rrethanat e ngjarjes të datës 17.08.2017 në Urgjencën e Sëmundjeve të Brendshme të QSU “Nënë Tereza”, nëpërmjet kqyrjes dhe verifikimit edhe të provave filmike të Institucionit tuaj, si dhe kanë dëgjuar pretendimet e palëve, në përfundim kanë konstatuar se, nuk ka prova të shkeljes të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore nga ana e mjekut Petrit Vargu dhe në këto kushte kanë vendosur ta **deklarojnë të pafajshëm anëtarin e UMSH, Dr.P.V.**

Gjithashtu sjellim në vëmendjen tuaj faktin se, referuar korespondencës zyrtare të zhvilluar mes Institucionit tonë me Drejtorinë e Përgjithshme të QSU “Nënë Tereza”, rezulton se, ende sot e kësaj dite nuk i jeni përgjigjur kërkesës tonë për dërgimin e kopjes së Vendimit Nr.560, datë 13.09.2017, kopjen e përgjigjes dhe të Vendimit të Këshillit Rajonal të Urdhërit të Mjekut të Shqipërisë, si dhe faktet shoqëruese që provojnë shkeljen e Etikës dhe protokolleve të mjekimit nga ana e këtij mjeku. Ky refuzim, përbën shkelje të detyrimit ligjor nga ana e organit që ju përfaqësoni për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit.

Sa më sipër, nga trajtimi i ankesës të z.P.V, konstatojmë se:

1. Drejtori i Përgjithshëm me shkresë Nr.prot. 3467, datë 19.08.2017 drejtuar z.P.V, ka njoftuar për zhvillimin e takimit në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të QSUT “Nënë Tereza” më datë 06.09.2017, ora 11.00, për të diskutuar mbi situatën e ndodhur në Urgjencën e Sëmundjeve të Brëndshme më datë 17.08.2017, takim i cili është shtyrë dhe është zhvilluar më datë 07.09.2017, ora 11.00.
2. Më datë 12.09.2017 në përgjigjen zyrtare të Institucionit tuaj drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit na bëni me dije se, çështja është dërguar për kompetencë e vendimarrje Urdhërit të Mjekëve të Shqipërisë.
3. Ndërkohë, më datë 13.09.2017 ju si titullar i Institucionit, keni marrë Vendim Nr.560, datë 13.09.2017 “Për Zgjidhjen e marrëdhënieve të punës”, për punonjësin e institucionit z.P.V, me detyrë mjek në Urgjencën e Sëmundjeve të Brëndshme.
4. Nisur nga respektimi i afateve ligjore gjatë procedimit administrativ të ankesave, nuk kuptohet qartë shkak i procedurës të përshpejtuar të ndjekur nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të QSUT “Nënë Tereza” në marrjen e këtij vendimi, ende pa pritur përgjigjen e Urdhërit të Mjekëve të Shqipërisë, në përbërje të të cilit është ngritur dhe funksionon Komisioni Disiplinor pranë këshillave rajonale dhe Këshillit Kombëtar. Ky Këshill ka për detyrë të shqyrtojë rastet e paraqitura mbi bazën e fakteve e provave të administruara dhe seancës dëgjimore me anëtarin e Urdhrit, ndaj të cilit mund të merret masa disiplinore. Pikërisht, në Nenin 16/2 të Ligjit Nr. 123/2014 “Për Urdhërin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë” thuhet shprehimisht se: “2. Komisioni

shqyrton ankesat e bëra nga çdo person apo institucion në organet e Urdhrit, të cilat lidhen me ushtrimin e profesionit dhe përbëjnë shkelje të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore”.

5. Ky fakt flet për cënim të së drejtës për proces të rregullt ligjor gjatë procedurës administrative, mungesës të kompetencës sipas këtij përcaktimi ligjor, si dhe të parimit të dhënies së ndihmës aktive apo parimit të objektivitetit, të parashikuara në nenet 10 dhe 14, të Ligjit Nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.
6. Gjithashtu, në shkresë tuaj Nr.3467/13 prot. datë 12.09.2017 drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit, bashkëngjitur keni dërguar midis të tjerave kopjen e proces verbalit të mbajtur në takimin e zhvilluar më datë 07.09.2017, theksoni se çështjet e ngritura në takim janë ende në proces vlerësimi nga ana juaj, dhe nuk ka një akt përfundimtarë të këtij organi kolegjal. Por, nga praktika juaj dhe dokumentacioni vënë në dispozicion nga ankuesi P.V, konstatojmë se, me shkresë Nr.prot.3683 datë 13.09.2017 ju keni marrë Vendim Nr.560 datë 13.09.2017, “*Për Zgjidhjen e marrëdhënieve të punës*” të ankuesit.
7. Mosvënia në dispozicion të Institucionit të Avokatit të Popullit e kopjes të vendimit të lartpërmendur, nuk është në përputhje me pikën 5, të nenit 98, të Ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ku thuhet shprehimisht se: “*Aktet e organeve kolegjiale bëhen në formë shkresore. Këto akte regjistrohen në një process-verbal, pa të cilin ato nuk sjellin asnjë pasojë juridike*”.
8. Ne gjykojmë se akti administrativ, Vendim Nr.560 datë 13.09.2017 i Drejtorit të Përgjithshëm të QSUT “Nënë Tereza”, ka elementë të munguar të nevojshëm, të formës shkresore të aktit administrativ, sikurse kërkohet nga neni 99, i Kodit të Procedurave Administrative. Qartazi këtij akti administrativ i mungon “arsyetimi i aktit”, që sipas përcaktimit të nenit 100, të po këtij kodi, duhet të jetë i qartë dhe përmban:
 - a) *Shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë akti,*
 - b) *Shpjegimin e përmbledhur të rezultatit të hetimit administrativ dhe të vlerësimit të provave,*
 - c) *Bazën ligjore të aktit dhe një shpjegim pse kushtet ligjore për zbatimin e tij plotësohen në këtë rast,*
 - d) *Në rastin e diskrecionit, shpjegimin pse diskrecioni është përdorur në mënyrën e përcaktuar.*

Gjithashtu Vendim Nr.560 datë 13.09.2017, nuk është në kushtet e cilësuar në nenin 101, të Kodit të Procedurave Administrative.

Në këto rrethana, ky akt nuk ekziston në kuptim të ligjit dhe nuk mund të sjellë pasoja juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo, nga ana juaj si i tillë. Nëpërmjet këtij rekomandimi sjellim në dijeninë tuaj faktin se, ky vendim vjen pikërisht në përputhje me rastet e parashikuara në nenin 108, të Kodit të Procedurave Administrative.

Si i tillë, Vendim Nr.560 datë 13.09.2017 i Drejtorit të Përgjithshëm të QSUT “Nënë Tereza”, duhet të konstatohet nga ana juaj si absolutisht i pavlefshëm, me anë të një vendimi revokimi.

Në këtë këndvështrim, duam t'ju kujtojmë përkufizimin tashmë të pranuar nga Parlamenti European, në lidhje me keqadministrimin nga ana e organeve të administrates publike, sipas të cilit: *“Keqadministrimi ndodh kur një organ publik, nuk vepron në përputhje me një rregull apo princip, i cili është i detyrueshëm për të”*.

Nga ana tjetër, në akordancë me pikën 2, të nenit 15, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.

Për sa më sipër, në mbeshtetje të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 21/b, të Ligjit Nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet shprehimisht se: *“Pas përfundimit të hetimeve, Avokati i Popullit.....,paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,si dhe, në përputhje me nenin 111, të Kodit të Procedurave Administrative, se: *“Organi publik ka detyrimin të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit administrative nëse vjen në dijeni për rastet e parashikuara në nenin 108 të këtij Kodi”*,

REKOMANDOJMË

Inicimin dhe përfundimin sa më të shpejtë të procedurës administrative për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Vendim Nr.560 datë 13.09.2017 i Drejtorit të Përgjithshëm të QSUT “Nënë Tereza”, për sa referohet në këtë rekomandim.

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit Nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, lutemi të na vini në dijeni për qëndrimin tuaj, ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermir KAPEDANI